

U0172384

Rregulla 92 *ter* Deklarata e Avdullah AVDIJAJT

Prokurori kundër. Haradinaj, Balaj and Brahimaj

IT-04-84-T

Rregulla 92 *ter* deklarata e dëshmitarit Avdullah AVDIJA

11 nëntor 2007

Nenshkrimi/ Inicialet: *Avdullah* Te tjere te Pranishem:

Faqja 1 e 7

INFORMATA MBI DËSHMITARIN

Mbiemri: Avdija

Emri: Avdullah

Data e lindjes: 21 nëntor 1966

Vendi i lindjes: Batushë, Gjakovë, Kosovë

Gjuhët e përdorura gjatë intervistës: shqip dhe anglisht

Emrat e të gjithë personave të pranishëm gjatë intervistës: David Re,
Catherine Driguet Versonnen, Romana Schweiger, Ardiana Sadikoviq

Nenshkrimi/ Inicialet: *Avdullah*..... Te tjere te Pranishem:
Faqja 2 e 7

Rregulla 92 ter Deklarata e Avdullah AVDIJAJT

Deklaratë Dëshmitari

1. Quhem Avdullah Avdija. Kam lindur në fshatin Batushë dhe kam jetuar aty për pjesen më të madhe të jetës. Tani, vazhdoj të jetoj në Batushë me gruan dhe fëmijët e mi. Kam kryer shërbimin ushtarak në APJ në vitin 1987-1988. Kontakti im i parë me UCK-në ka qenë në fillim të marsit 1998 kur kam shkuar në Tropojë (Shqipëri) për të marrë armë. Kam udhëtuar në këmbë me tre shokë të mijë. U kthyem disa ditë më vonë natën me 420 persona tjerë në kolonë duke bartur armatimin e ngarkuar në kuaj. Në Tropojë e morra një Kallashnikov dhe 1000 fishekë. Armatimi u shkarkua në Smolicë. Armën e morra me vete në shtëpi.
2. Me familjen e Seid Nocit kam lidhje familjare si me poshtë vijon: Motra ime, Sadije është e martuar me Jakup Nocin (vëllai i Seid Nocit); vëllai im i madh Dërvishi, është i martuar me motrën e Jakup Nocit; vëllai im, Rama është martuar me vajzën e Osman Nocit; kushëriri im është i martuar me Cyman, vajzën e Rexhep Nocit (axha i Seid Nocit). Kur familja e Seid Nocit jetonte ende në Batushë, unë kam patur marrëdhene të afërtë me familjen e Seid Nocit dhe jemi takuar shpesh. Kur familja e Seid Nocit vjen nga Austria për të vizituar Kosovën, unë normalisht takohem me ta.
3. Seid Noci nuk punonte sepse ishte handikap, dhe kishte vetëm një gisht në njerën prej duarve. Me duket se ishte dora e djathtë. Për shkak të këtij invaliditeti ai merrte një pension. Une nuk e kam pare kurre Seid Nocin me uniforme apo arme. Ai nuk ka qene pjesetar i UCK-se apo i ushtrise serbe.
4. Ne fillim te 1998-es, une jetoja ne fshatin Batushe. Batusha popullohej nga shqiptare, nuk ka patur familje serbe aty. Batusha ka vetem rreth 2500 banore dhe njerezit ne pergjithesi e njohin njeri-tjetrin.
5. Me 29 maj 1998, forcat serbe sulmuant fshatrat Brovine dhe Moliq dhe me pas fshatin Batushe. Nga 30 maji 1998, serbet ngriten një pike kontrolli ne Nenshkrimi/ Inicialet:*Mehmetaj*..... Te tjere te Pranishem:

Rregulla 92 ter Deklarata e Avdullah AVDIJAJT

kryqezimin midis Junikut dhe fshatit Batushe. Kur serbet moren Batushen, shume fshatare u larguan per shkak te frikes nga serbet.

6. Me 1 qershor 1998, une dhe familja ime u larguan gjithashtu nga Batusha me fshatare te tjere per shkak te rritjes se tensionit dhe rrezikut ne territorin qe mbahej nga serbet. Ne grupin qe u largua nga fshati ishin edhe Myftar Delija me familjen e tij. Ne shkuam ne Koshare. Prej andej une dhe familja ime vazhduam me tej kaluam kufirin shqiptar per ne Tropoje. Myftar Delija dhe Seid Noci qendruan me familjet e tyre ne Koshare ne shtepine e Skender Gjonit. Myftar Delija kishte prone te konsiderueshme ne Batushe dhe nuk donte te shkonte shume larg prones se tij. Kafshet e mia i lashe ne Koshare ne shtepine e Skender Gjonit.
7. Kemi arritur ne Tropoje ne Shqiperi, qe eshte rrreth shtate ore me kembe nga Koshara, me nje grup prej 300 vetash nga Batusha. Kam qendruar ne Tropoje per ca kohe. Pastaj jam kthyer ne Kosove me nje grup rrreth 14 te rinjsh, udhehequr nga Besim Alija Rama. Kemi marre arme nga Shqiperia dhe kemi shkuar ne Shtabin e UCK-se ne Junik, (Kosove). Mendoj se kemi ardhur ne Junik ne korrik 1998.
8. Nje dite ne korrik 1998, Besim Alija Rama udheheqesi im ne UCK, me tha përderisa ecnim rrugës mbi urën e pare ne fshatin Junik se Seid Noci kerkohet nga UCK-ja. Ai nuk me tha pse apo, detaje te tjera. Besim Alija Rama propozoi qe te shkonim bashke ne Koshare te merrnim Seid Nocin. Besim Alija Rama ka folur me Deli Delijan (kusheririn e Seid Nocit) se Seid Noci duhet te shkonte ne Shtabin e UCK-se ne Junik. Kam degjuar nga fshatare te tjere se Deli Delija i ka premtuar Besim Alija Rames se ai do e sillte Seid Nocin ne UCK.Deli Delija nuk ishte vete pjesetare i UCK-se, por ishte shok i Rames. U ktheva ne nje shteti ne Junik, ku pjesetaret e UCK-se flinin dhe pushonin, dhe ku UCK-ja mbante armet.

Nenshkrimi/ Inicialet: Avdullah Te tjere te Pranishem:
Faqja 4 e 7


Rregulla 92 ter Deklarata e Avdullah AVDIJAJT

9. Te nesermen kam degjuar nga njerez aty emrat e te cileve nuk me kujtohen me, se ate nate ka ndodhur si me poshte: Besim Alija Rama ka shkuar ne shtepine e Skender Gjonit ne Koshare, ku qendronin familjet Noci dhe Delija. Kishte veshur nje uniforme me shenjen dalluese te UCK-se dhe kishte arme me vete. Qendroi perballë shtepise dhe thirri emrin e Deli Deliajt. Seid Noci shkoi te dritarja dhe pyeti: "Kush po therret?" Besim Alija Rama u pergjigj: "Jam une, Besimi!" Keshtu, Seid Noci u kthye dhe i thote Deli Deliajt: "Po me kerkon UCK-ja!" Deli Delija pastaj doli nga shtepia per te folur me Besim Alija Ramen. Ata folen mes tyre dhe meqe nuk rane ne ujdi Deli Delija tha se nuk ishte ide e mire qe ta merrnin Seid Nocin. Keshtu, Besim Alija Rama u largua pa Seid Nocin.
10. Te nesermen, kam pare Deli Delijan dhe Besim Alija Ramen duke folur ne rruge prane shtabit ne Junik. Edhe une isha ne rruge rreth 200-300 metra larg dhe nuk mund te degjoja se cfare po flisnin. Rreth ores 15, po te kesaj dite, Deli Delija me ftoi ne shtepi ne Koshare ku po qendronin. Une pranova sepse dëshiroja të vizitoj bagëtinë dhe të pastrohem dhe arritem aty rreth ores 18. Une isha i veshur me uniforme me shenjen dalluese te UCK-se. Ne shtepi ishin Zeneli, Myftari, Bashkimi se bashku me gruan dhe femijet, Hatmonia, Xhemilja, Qendresa, Lirimi dhe Mendim Delija si dhe Seidi, Mimoza dhe Ajnisha Noci. Nga sjellja e tij mu duk se Myftar Delija ishte i dehur. Ai ishte i shqetesuar se UCK-ja kishte kerkuar Seidin naten e meparshme.
11. U ulem dhe folet dhe ata me ofruan te haja dhe te pija. Me ftesen e tyre une e kalova naten ne shtepine e tyre. Te nesermen burrat e familjes ishin ulur nen nje arre dhe po diskutonin se cfare te benin me Seid Nocin. Seid Noci me pyeti i frikesuar nese mund ta ndihmoja te ikte ne Shqiperi. I shpjegova se nuk mund ta ndihmoja, sepse jam pjesetar i UCK-se, por une i sugjerova qe Delia apo Bashkimi mund ta ndihmonin. Seid Noci ishte shume i frikesuar sepse po e kerkonte UCK-ja. Myftar Delija ishte shume i shqetesuar. Ai i bertiti Seid Nocit ne menyre agresive: "shko ku te duash, ose ne Shqiperi, ose dorezoju UCK-se! Jam i lodhur me ty dhe UCK-ne." Nuk e di me siguri se c'kuptim Nenshkrimi/ Inicialet: ..*Avdullah*..... Te tjere te Pranishem:
Faqja 5 e 7

Rregulla 92 *ter* Deklarata e Avdullah AVDIJAJT

kishte kjo tamam, por kete degjova Myftari t'i thoshte Seidit. Rreth 10 deri 15 minuta me vone Seid Noci propozoi te shkonte ne Junik per te mesuar arsyet perse kerkohet nga UCK-ja.

12. Se fundmi, Seid Noci u tha te gjithe pjesetareve te familjes se ai do t'i dorezohej UCK-se dhe familja vendosi qe Deli Delija dhe une te shkonim aty me te. Para se te largoheshim nga shtepia Seid Noci u vesh si duhet. Me sa mbaj mend ai veshi nje xhakete te erret.
13. Seid Noci, Deli Delija dhe une shkuam drejt Junikut derisa arritem pikën e kontrollit te UCK-se ne nje shteg, rreth 1500 metra larg nga Juniku. Po shenoj vendndodhjen e pikes se kontrollit ne harten bashkangjitur kesaj deklarate. Ne pikën e kontrollit ishin tre-kater ushtare te UCK-se te cilet nuk i njihja. Une vazhdova rrugen per Junik, sepse isha i veshur me uniforme dhe me shenjen dalluese te UCK-se dhe s'e kisha problem te kaloja pikën e kontrollit. Seid Noci dhe Deli Delija mbeten pas te pika e kontrollit. Kjo ishte hera e fundit qe pashe Seid Nocin dhe Deli Delijan. Ne ate kohe Seid Noci ishte rreth 50 vjec.
14. Pas kesaj kam qendruar tre ose kater dite ne Junik dhe per arsyen mjekesore shkova ne Tropoje per te pare familjen dhe per t'u vizituar te doktori. Pasi forcat serbe sulmuan dhe pushtuan Junikun, kam degjuar nga njerez ne Tropoje se UCK-ja e kishte marre Seid Nocin.
15. Unë isha në UCK gati një muaj, deri në fund të korrikut të vitit 1998 kur edhe shkova në Shqipëri dhe qëndrova aty deri në fund të vitit.

Nenshkrimi/ Inicialet:  Te tjere te Pranishem:
Faqja 6 e 7


VËRTETIM I PËRKTHYESIT

Unë, Ardiana Sadikoviq, përkthyese, vërtetoj se:

1. Jam e kualifikuar dhe e miratuar nga Sekretaria e Tribunalit Ndërkombëtar për Ndjekjen Penale të Personave Përgjegjës për Shkelje të Rënda të së Drejtës Ndërkombëtare të Kryera në Territorin e ish-Jugosllavisë që prej 1991 për të përkthyer nga gjuha shqipe në gjuhën angleze dhe nga gjuha angleze në gjuhën shqipe.
2. Jam informuar nga Avdullah Avdija se ai e flet dhe e kupton gjuhën shqipe.
3. Kam përkthyer me shkrim deklaratën e mësipërme nga gjuha angleze në gjuhën shqipe në prani të Avdullah Avdija i cili duket se e ka kuptuar përkthimin që i kam bërë unë kësaj deklarate.
4. Avdullah Avdija ka vërtetuar se faktet dhe çështjet e paraqitura në këtë deklaratë të përkthyera nga unë, janë të vërteta me sa di dhe me sa i kujtohet dhe rrjedhimisht ka nënshkruar në vendet përkatëse.

Nënshkrimi:/nënshkrim/

Data

Nenshkrimi/ Inicialet: ...... Te tjere te Pranishem:
Faqja 7 e 7